



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.94

25 qershor

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Dekret nr.6175 datë 19.5.2009	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	4171
Dekret nr.6176 datë 19.5.2009	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	4171
Vendim i KM nr.681, datë 11.6.2009	Për trajtimin e kredive të transferuara nga bankat e nivelit të dytë, me kapital tërësisht shtetëror, në agjencinë e trajtimit të kredive, për kriteret dhe kushtet për ndryshimin e marrëveshjes së kredisë, si dhe procedurat e marrjes në pronësi të pasurive, të lëna si garanci ose jo nga huamarrësit, të administrimit, shitjes dhe dhënies me qira apo me enfiteozë të këtyre pasurive.....	4172
Vendim i BSH nr.40, datë 27.05.2009	Për miratimin e rregullores “Mbi parimet bazë të drejtimit të bankave dhe degëve të bankave të huaja dhe kriteret për miratimin e administratorëve të tyre”	4175
Vendim i ERE-s nr.41, datë 25.5.2009	Për miratimin e rregullave dhe procedurave standarde të tenderimit për kushtet e financimit të OSSH –sh.a.....	4187
Vendim i ERE-s nr.42, datë 25.5.2009	Për miratimin e rregullave dhe procedurave standarde të prokurimit të energjisë elektrike nga OSSH-sh.a.....	4188
Vendim i ERE-s nr.43, datë 28.5.2009	Për miratimin e transferimit të aseteve nga shoqëria Korporata Energjetike Shqiptare sh.a. te shoqëria Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a.....	4188
Vendim i ERE-s nr.44, datë 28.5.2009	Për miratimin e ndryshimit të pronësisë së aksioneve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a. (OSSH).....	4189

Vendim i ERE-s nr.45, datë 28.5.2009	Për fillimin e procedurave për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Favina 1” sh.p.k. me seri PV05V, nr.29, lëshuar me vendimin e bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.85, datë 27.12.2005.....	4190
Vendim i ERE-s nr.46, datë 28.5.2009	Për një ndryshim në vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.63, datë 13.6.2008 “Për dhënien e licencës në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë dhe prodhimin e energjisë elektrike” (Parku eolik Kavajë).....	4190
Vendim i ERE-s nr.47, datë 4.6.2009	Për miratimin e marrëveshjes për pjesëmarrje në treg.....	4191

DEKRET
Nr.6175, datë 19.5.2009

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” të Kushtetutës, të nenit 9 dhe të nenit 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Madalina-Elena Sergiu-Eugen Kallanxhi (David)
2. Xhavit Rexhep Berisha
3. Ilirjana Januz Berisha (Gutaj)
4. Enes Xhavit Berisha
5. Edon Xhavit Berisha
6. Mustafa Ahmet Güven
7. William Nelson Forrest Niven
8. Bylong-Tak Hi-Dong Song
9. Erkan Erdem Ercan Derin
10. Xhelal Rafiz Ismali
11. Fitore Shefqet Tarani (Grezda)
12. Adil Mustafë Mustafa
13. Sehare Qemal Mustafa (Xheladini)
14. Blerina Adil Mustafa
15. Blerta Adil Mustafa

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET
Nr.6176, datë 19.5.2009

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” të Kushtetutës, të neneve 14, 19 dhe 24 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ

Neni 1

U rrijepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Endris Burhan Millo
2. Fran Mark Gegaj (Gega)
3. Tonin Mark Gegaj (Gega)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

VENDIM **Nr.681, datë 11.6.2009**

PËR TRAJTIMIN E KREDIVE TË TRANSFERUARA NGA BANKAT E NIVELIT TË DYTË, ME KAPITAL TËRËSISHT SHTETËROR, NË AGJENCINË E TRAJTIMIT TË KREDIVE, PËR KRITERET DHE KUSHTET PËR NDRYSHIMIN E MARRËVESHJES SË KREDISË, SI DHE PROCEDURAT E MARRJES NË PRONËSI TË PASURIVE, TË LËNA SI GARANCI OSE JO NGA HUAMARRËSIT, TË ADMINISTRIMIT, SHITJES DHE DHËNIES ME QIRA APO ME ENFITEOZË TË KËTYRE PASURIVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18 të ligjit nr.9731, datë 10.5.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8894, datë 14.5.2002 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”, të ndryshuar”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. TRAJTIMI I KREDIVE TË TRANSFERUARA NGA BANKAT E NIVELIT TË DYTË, ME KAPITAL TËRËSISHT SHTETËROR

1. Agjencia e Trajtimit të Kredive (më poshtë ATK), me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, nëpërmjet ndryshimit të marrëveshjes së kredisë me debitorin, ka të drejtë të ristrukturojë njërën prej kushteve të mëposhtme, të parashikuara në këtë marrëveshje kredie.

1.1. Për debitorët, të cilët, në datën e transferimit të kredisë nga bankat, e kanë pasur shumën e principalit, deri në 3 000 000 (tre milionë) lekë:

a) faljen, në masën 95%, të interesave, të kamatëvonesave dhe gjobave, në rast se paraqiten për të shlyer detyrimin në periudhën maj-shtator 2009;

b) faljen, në masën 90%, të interesave, të kamatëvonesave dhe gjobave, në rast se paraqiten për të shlyer detyrimin në periudhën shtator-dhjetor 2009;

c) faljen, në masën 80%, të interesave, të kamatëvonesave dhe gjobave, në rast se paraqiten për të shlyer detyrimin në periudhën janar-qershor 2010;

ç) faljen, në masën 60%, të interesave, të kamatëvonesave dhe gjobave, në rast se paraqiten për të shlyer detyrimin pas muajit qershor 2010;

d) konvertimin, sipas kursit fiks të Bankës së Shqipërisë në çastin e transferimit, për kreditë e transferuara në valutë;

dh) periudha e likuidimit me këste nuk mund të jetë më shumë se 1 (një) vit, nga data e lidhjes së kontratës së re.

1.2. Për të gjithë debitorët, që kanë marrë kredi për mekanikë bujqësore (autokombajna, traktorë, makineri e agregate bujqësore), prodhim dhe përpunim të produkteve bujqësore e blegtorale, linjë prodhimi dhe përpunimi të produkteve bujqësore dhe blegtorale, dhe mjete të transportit:

a) kushtet dhe afatet e përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d” e “dh” të pikës 1.1 të këtij vendimi, janë të vlefshme edhe për faljen e interesave, të kamatëvonesave dhe gjobave,

b) me principal të transferuar mbi 3 000 000 (tre milionë) lekë, periudha e likuidimit me këste nuk mund të jetë më shumë se dy vjet nga data e lidhjes së kontratës së re.

1.3. Për debitorët që, në datën e transferimit të kredisë nga bankat, e kanë pasur shumën e principalit mbi 3 000 000 (tre milionë) lekë:

a) faljen, në masën 85 për qind, të interesave, të kamatëvonesave dhe gjobave, nëse paraqiten

për të shlyer detyrimin në periudhën maj- shtator 2009;

b) faljen, në masën 80 për qind, të interesave, të kamatëvonesave dhe gjobave, nëse paraqiten për të shlyer detyrimin në periudhën shtator-dhjetor 2009;

c) faljen, në masën 75 për qind, të interesave, të kamatëvonesave dhe gjobave, nëse paraqiten për të shlyer detyrimin në periudhën janar-qershor 2010;

ç) faljen, në masën 65 për qind, të interesave, të kamatëvonesave dhe gjobave, nëse paraqiten për të shlyer detyrimin pas muajit qershor të vitit 2010;

d) konvertimin, sipas kursit fiks të Bankës së Shqipërisë në çastin e transferimit, për kreditë e dhëna në valutë;

dh) periudha e pagesës së shumës së mbetur të kredisë nuk mund të jetë më e gjatë se 2 (dy) vjet nga data e lidhjes së kontratës së re.

1.4. Për debitorët, që kanë marrë kredi për banesa ose për përmirësimin e kushteve të banimit:

a) faljen, në masën 80 për qind, të interesave, të kamatëvonesave dhe gjobave, për debitorët me vendndodhje në bashkitë: e Tiranës, të Durrësit, të Sarandës, të Fierit dhe të Vlorës;

b) faljen, në masën 100 për qind, të interesave, të kamatëvonesave dhe gjobave, për debitorët me vendndodhje në të gjitha bashkitë e tjera;

c) periudha e pagesës së shumës së mbetur të kredisë nuk mund të zgjatet më shumë se 3 vjet nga data e lidhjes së kontratës së re;

ç) llogaritja e detyrimit të ri të bëhet duke zbatuar normën e interesit 10 për qind në vit, me përjashtim të kredive, që, në marrëveshjen ekzistuese të huasë, e kanë normën e interesit më të ulët.

1.5. Detyrimet e transferuara nga bankat, për shpenzime gjyqësore dhe përmbarimore, nuk falen.

1.6. Për debitorët, që kanë vdekur:

a) u kërkohet trashëgimtarëve të tyre të likuidojnë vetëm shumën e principalit të mbetur;

b) periudha e pagesës së shumës së mbetur të kredisë nuk mund të zgjatet më shumë se 3 vjet, në varësi të llojit të kredisë.

1.7. Faljen e të gjitha detyrimeve të transferuara nga bankat, të përbëra vetëm nga interesa, penalitete dhe/apo kamatëvonesa.

1.8. Për debitorët, të cilëve u kanë përfunduar procedurat e shitjes së kolateralit dhe vazhdojnë të jenë debitorë të ATK-së, u kërkohet likuidimi vetëm i 50 për qind të detyrimit të mbetur pas rristrukturimit.

1.9. Debitorët, që kanë lidhur kontrata rristrukturimi, në bazë të akteve ligjore e nënligjore, në fuqi, para datës 30.4.2009, gëzojnë të drejtën e trajtimit sipas kushteve favorizuese të këtij vendimi.

2. Për efekt të zbatimit të pikës 1 të këtij kreu, për të gjithë debitorët:

2.1 Pavarësisht nga shuma e principalit të transferuar, të gjitha pagesat e kryera në ATK për interesa, gjoba dhe kamatëvonesa përllogariten si shuma, që zbriten nga principalit i transferuar.

2.2. Për të cilët nuk ka dalë urdhri i ekzekutimit, llogaritja e mëtejshme e interesave shtrihet deri më 30.4.2009, me përjashtim të kredive të marra për banesa apo përmirësim të kushteve të banimit.

2.3. Pavarësisht nga faza e trajtimit ligjor, në të cilën ndodhen, gëzojnë të drejtën e rristrukturimit dhe të përfitimit të lehtësive.

3. Për të gjithë debitorët, që likuidojnë menjëherë principalin e transferuar apo të mbetur brenda muajit dhjetor 2009, faljen e të gjitha interesave, kamatëvonesave dhe gjobave, pavarësisht nga shuma e principalit të transferuar.

II. PROCEDURAT E MARRJES NË PRONËSI TË PASURIVE TË LËNA SI GARANCI OSE JO NGA DEBITORËT; TË ADMINISTRIMIT, SHITJES E DHËNIES ME QIRA APO ME ENFITEOZË TË KËTYRE PASURIVE

1. Këtij vendimi u nënshtrohen të gjitha pasuritë e lëna garanci ose jo nga debitorët e ATK-së, të cilat kalojnë në pronësi të saj, pasi nuk janë shitur në ankandet e zhvilluara nga përmbaruesi gjyqësor, në zbatim të procedurave ligjore për ekzekutim të detyrueshëm.

2. Marrja në pronësi e pasurive të lëna garanci ose jo nga debitorët bëhet me pëlqimin e ATK-së, si palë kreditore, kundrejt vlerës së ankandit të fundit, të zhvilluar nga përmbaruesi gjyqësor.

3. Administrimi i pasurive, që kalojnë në pronësi të ATK-së, bëhet sipas rregullave të përcaktuara në ligjin nr.6942, datë 25.12.1984 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare”, të ndryshuar, dhe të vendimeve nr.70, datë 11.3.1985 e nr.445, datë 25.12.1990 të Këshillit të Ministrave.

4. AKT-ja e kontabilizon pronën me vlerën e përcaktuar nga përmbaruesi gjyqësor në vendimin për kalimin e pronësisë.

5. ATK-ja, pas kontabilizimit të pronës, kundrejt shlyerjes së menjëhershme të detyrimit të ristrukturuar, sipas përcaktimeve të bëra në kreun I të këtij vendimi, i propozon debitorit kthimin e sendit të marrë në pronësi. Debitori duhet të kthejë përgjigje, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit. Pas kalimit të këtij afati, ATK-ja përgatit dosjen për shitjen me ankand.

6. Procedurat e ankandit organizohen nga ATK-ja, duke respektuar procedurat e shitjes së pronës shtetërore, të parashikuara në kreun III të vendimit nr.1638, datë 17.12.2008 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet, dhe për procedurën e shitjes”, për aq sa është i zbatueshëm në kushtet specifike të funksionimit të ATK-së. Si vlerë fillestare e pronës, që do të shitet me ankand, do të jetë vlera e kontabilizuar nga kjo agjenci.

7. ATK-ja ka të drejtën e rivlerësimit të pronës, para fillimit të procedurave të shitjes me ankand, me kusht rritjen e vlerës fillestare, kur e gjykon të arsyeshme se kanë ndryshuar pozitivisht kushtet e tregut, në zonën ku kjo pronë ndodhet.

8. Pronat e kaluara në pronësi të ATK-së, me propozimin e Ministrit të Financave, mund t’i transferohen shtetit dhe t’u kalojnë në përgjegjësi administrimi institucioneve shtetërore. Në këtë rast, vlera e pronës, e parashikuar në pikën 4 të këtij kreu, pasqyrohet nga ATK-ja, për efekt të deklarimit të realizimit të të ardhurave, dhe kontabilizohet, duke zbritur detyrimin e debitorit.

III. KRITERET DHE KUSHTET, QË DUHEN PLOTËSUAR PËR NDRYSHIMIN E MARRËVESHJES SË KREDISË, ZËVENDËSIMIN E DEBITORIT DHE TË KOLATERALIT

1. Debitori ka të drejtë të kërkojë ristrukturimin e detyrimit, sipas lehtësive të parashikuara në këtë vendim, vetëm një herë. Në rast se debitori nuk u përmbahet kushteve të marrëveshjes së lidhur, kërkohet likuidimi i detyrimit të kontabilizuar në ATK.

2. Për debitorët, që parapëlqejnë shlyerjen me këste, nënshkrimi i kontratës së ristrukturimit shoqërohet me pagesën e menjëhershme, në masën 20% të principalit të transferuar apo shumës së mbetur prej tij.

3. Për debitorët, që kanë marrë kredi për banesa ose përmirësimin e kushteve të banimit, nënshkrimi i kontratës së ristrukturimit shoqërohet me pagesën e menjëhershme, në masën 40 %, të principalit të transferuar apo të shumës së mbetur prej tij, si dhe duke vendosur kushtet për shlyerjen e pjesës tjetër.

4. Kriteret, kushtet dhe afatet e përcaktuara në këtë vendim, për ristrukturimin e detyrimit, nuk e pengojnë agjencinë të kërkojë vjeljen e detyrimit të debitorëve në çdo kohë.

5. Zëvendësimi i debitorit apo i kolateralit me një person a pasuri tjetër realizohet në përputhje me përcaktimet e Kodit Civil dhe të ligjit nr.8894, datë 14.5.2005 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”, të ndryshuar, si më poshtë vijon:

a) Zëvendësimi i debitorit realizohet kur vlera e pasurisë së re, që do të ngarkohet me barrë hipotekore, dhe e kolateralit ekzistues mbulojnë të paktën 150% të detyrimit të mbetur për t’u likuiduar.

b) Nënshkrimi i marrëveshjes për zëvendësimin e debitorit shoqërohet me likuidimin e menjëhershëm të 50% të principalit të transferuar apo atij të mbetur. Debitori i ri gëzon të drejtën e ristrukturimit të detyrimit sipas kërkesave të kreut I të këtij vendimi.

c) Zëvendësimi i kolateralit realizohet, kur vlera e pasurisë së re, që do të ngarkohet me barrë hipotekore, mbulon të paktën 150% të detyrimit të mbetur për t’u likuiduar.

ç) Procedura e zëvendësimit të kolateralit shoqërohet me pagesën, nga debitori, të 20 % të principalit të transferuar apo atij të mbetur.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ngarkohet Ministri i Financave të nxjerrë udhëzimin përkatës në zbatim të këtij vendimi.

2. Vendimi nr.1045, datë 16.7.2008 i Këshillit të Ministrave dhe udhëzimi nr.29, datë 6.10.2008 i Ministrit të Financave, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.40, datë 27.05.2009

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “MBI PARIMET BAZË TË DREJTIMIT TË BANKAVE DHE DEGËVE TË BANKAVE TË HUAJA DHE KRITERET PËR MIRATIMIN E ADMINISTRATORËVE TË TYRE”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a” dhe të nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të nenit 24, pika 1, shkronjat “c” dhe “ë” dhe pika 2 shkronja ”b”, dhe të neneve 40 shkronja “c”, 42 dhe 43 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Mbi parimet bazë të drejtimit të bankave dhe degëve të bankave të huaja dhe kriteret për miratimin e administratorëve të tyre”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes me zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritetit Europian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, rregullorja “Për administratorët e bankave dhe të degëve të bankave të huaja” miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.120, datë 30.12.2003 dhe ndryshuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.69, datë 13.9.2006, shfuqizohet.

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

SEKRETARI
YLLI MEMISHA

ZËVENDËSKRYETARI
FATOS IBRAHIMI

RREGULLORE
“MBI PARIMET BAZË TË DREJTIMIT TË BANKAVE DHE DEGËVE TË BANKAVE TË HUAJA DHE KRITERET PËR MIRATIMIN E ADMINISTRATORËVE TË TYRE”
(Miratuar me vendimin nr.40, datë 27.5 2009 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë)

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është:

a) përcaktimi i parimeve dhe rregullave bazë për një drejtim të përgjegjshëm dhe efektiv të bankave dhe degëve të bankave të huaja;

b) përcaktimi i kriterëve që duhet të përmbushin administratorët e bankave dhe degëve të bankave të huaja, si dhe i dokumentacionit të nevojshëm për miratimin e tyre nga Banka e Shqipërisë;

si dhe

c) përcaktimi i kriterëve për lidhjen e marrëveshjeve me të tretët për ushtrimin e funksioneve dhe përgjegjësi për administrimin dhe drejtimin e bankës.

Neni 2 Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat dhe degët e bankave të huaja, të cilat ushtrojnë veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me licencën e lëshuar nga Banka e Shqipërisë.

Neni 3 Baza juridike

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a” dhe të nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të nenit 24, pika 1, shkronjat “c” dhe “ë” dhe pika 2 shkronja “b”, dhe të neneve 40 shkronja “c”, 42 dhe 43 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 4 Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar sipas ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termi i mëposhtëm ka këtë kuptim:

“plani për vazhdimësinë (vijimësinë) e aktivitetit të bankës” – është tërësia e masave të hartuara nga banka ose dega e bankës së huaj për të siguruar, sipas skenarëve në rastin e situatave të ndryshme të krizave, vazhdimësinë e aktivitetit kryesor të bankës, pavarësisht mosfunksionimit të shërbimeve të ofruara nga të tretët.

KREU II PARIMET DHE RREGULLAT BAZË TË DREJTIMIT TË PËRGJEGJSHËM DHE EFEKTIV

Neni 5 **Organet drejtuese dhe kultura e përgjithshme e drejtimit**

1. Këshilli drejtues dhe/ose drejtoria, në zbatimin e detyrave dhe përgjegjësi që lidhen me drejtimin dhe kontrollin e subjektit, njohin profilin e rrezikut dhe sigurojnë që nivelet e kapitalit të mbulojnë mjaftueshëm këtë rrezik.

2. Këshilli drejtues dhe drejtoria, nëpërmjet mënyrës së drejtimit, nxisin (stimulojnë) një kulturë të përshtatshme drejtimi, e cila ka për përparësi ndershmërinë dhe krijimin e marrëdhënieve korrekte ndërmjet nëpunësve, të bazuar në standarde të larta profesionale dhe vlera të larta etike.

3. Këshilli drejtues, në bashkëpunim me drejtorinë, marrin masa për arritjen e standardeve të larta etike dhe profesionale në drejtimin e bankës.

Neni 6 **Këshilli drejtues**

Këshilli drejtues, në funksion të drejtimit të bankës në përputhje me objektivat, strategjitë dhe politikat e miratuara, si dhe në interesin më të mirë të saj, shqyrton dhe vlerëson:

a) zhvillimin dhe mbajtjen e një niveli të mjaftueshëm të ekspertizës profesionale në përputhje

me rritjen dhe kompleksitetin e aktivitetit të bankës;

b) sigurinë dhe qëndrueshmërinë financiare të bankës, si dhe njohjen e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi ;

c) parandalimin dhe shmangien e konflikteve të mundshme të interesit në veprimtarinë dhe vendimmarrjen e bankës; si dhe

d) mbrojtjen e interesave të klientëve, investitorëve dhe të publikut në përgjithësi.

Neni 7

Drejtoria

1. Drejtoria organizon dhe drejton në mënyrë të vazhdueshme veprimtarinë e subjektit.

2. Drejtoria përcakton dhe mund të delegojë detyrat tek personeli, si dhe mbikëqyr ushtrimin e përgjegjësisë të deleguara, në përputhje me politikat dhe procedurat e miratuara.

3. Drejtoria ndërmerr masat e nevojshme për të monitoruar dhe administruar të gjitha rreziqet materiale të bankës, në përputhje me strategjitë e miratuara.

4. Drejtoria zbaton politikat dhe strategjitë e miratuara, si dhe siguron që proceset e administrimit të rrezikut të jenë në përshtatje të vazhdueshme me profilin e rrezikut të subjektit dhe planin e biznesit të miratuar.

Neni 8

Bashkëpunimi i organeve drejtuese

1. Këshilli drejtues dhe drejtoria, në bashkëpunim ndërmjet tyre, marrin vendime në interesin më të mirë të bankës, të cilat duhet të ndikojnë në drejtimin dhe kontrollin e kujdesshëm të saj, lidhur me çështjet e mëposhtme:

a) objektivat e veprimtarisë;

b) politikat dhe udhëzimet për arritjen e këtyre objektive;

c) strategjitë për ndërmarrjen e rreziqeve dhe administrimin e tyre; si dhe

d) analizat lidhur me profilin e rrezikut.

2. Këshilli drejtues dhe drejtoria përdorin në mënyrë efektive informacionet dhe konkluzionet e marra nga njësisë ose sistemi i kontrollit të brendshëm, eksperti kontabël i autorizuar dhe struktura të tjera të ligjshme të kontrollit të bankës.

Neni 9

Autonomia e administratorëve

1. Administratorët, brenda kompetencave të përcaktuara nga ligji, aktet nënligjore dhe organet drejtuese, vlerësojnë dhe marrin në mënyrë të pavarur dhe objektive, vendime lidhur me veprimtarinë e subjektit.

2. Në zbatim të përcaktimeve të paragrafit 1 të këtij neni, administratori merr në konsideratë të gjithë informacionin e vlefshëm, të mjaftueshëm dhe të plotë, si dhe faktorë të tjerë përkatës që mund të ndikojnë në këto vendime.

Neni 10

Paga, shpërblimi dhe përfitime të tjera

1. Këshilli drejtues, në përputhje me strategjinë, objektivat afatgjatë të veprimtarisë së bankës dhe ecurinë e performancës së saj, miraton politikat dhe rregullat e shpërblimit të anëtarëve të drejtorisë.

2. Paga, shpërblimi dhe kompensime të tjera të anëtarëve të drejtorisë të bankës përcaktohen nga këshilli drejtues. Për këtë qëllim, këshilli drejtues mund të asistohet nga një komitet i krijuar prej tij.

3. Këshilli drejtues ose komiteti i krijuar për këtë qëllim prej tij, mbikëqyr shpërblimin e anëtarëve të drejtorisë, duke u siguruar që ky shpërblim është kryer sipas kërkesave të pikës 1 të këtij neni.

Neni 11

Efektiviteti i punës së këshillit drejtues

1. Drejtoria informon rregullisht këshillin drejtues të bankës, në mënyrë të plotë dhe në kohën e duhur, për çështjet e rëndësishme që lidhen me operacionet e bankës; sidomos për administrimin e rrezikut, zbatimin e strategjive dhe politikave, si dhe për çdo shmangie nga objektivat e miratuara.

2. Këshilli drejtues informohet nga drejtoria mbi profilin e rreziqeve të bankës nëpërmjet raporteve të administrimit të rrezikut që i prezantohen në formën e përcaktuar prej tij. Mbështetur në këto raporte këshilli drejtues rishikon rregullisht politikat e miratuara dhe vlerëson në vazhdimësi përshtatshmërinë e tyre me zhvillimet e bankës dhe të tregut.

Neni 12

Komitetet e krijuara nga këshilli drejtues

1. Këshilli drejtues, në rast se e çmon të nevojshme, mund të krijojë komitete të veçanta në funksion të trajtimit dhe përgatitjes së propozimeve për çështje të veçanta, si dhe për mbikëqyrjen e zbatimit të vendimeve të tij.

2. Krijimi i komiteteve të tilla duhet të sigurojë që mandatet, përbërja dhe procedurat e punës së tyre të jenë të përcaktuara mirë në funksion të qëllimit të krijimit të tyre.

3. Çdo komitet i krijuar nga këshilli drejtues sipas këtij neni përbëhet nga një kryetar dhe të paktën dy anëtarë.

KREU III

KRITERET PËR KUALIFIKIMET, PËRVOJËN DHE KËRKESAT PËR DOKUMENTACIONIN E MIRATIMIT TË ADMINISTRATORËVE

Neni 13

Kriteret për kualifikimet dhe përvojën

1. Administrator i subjektit mund të jetë individ me reputacion të lartë etik dhe profesional, me kualifikim dhe përvojë profesionale në drejtim.

2. Kualifikimi dhe përvoja profesionale në drejtim duhet të jenë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për natyrën, përmasat dhe kompleksitetin e veprimtarisë së subjekteve, sipas përcaktimeve të pikave 3 dhe 4 të këtij neni.

3. Administratorët e propozuar zotërojnë kualifikim dhe përvojë profesionale të mjaftueshme dhe të përshtatshme, në rastet kur plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) zotërojnë diplomë universitare ose pasuniversitare në ekonomi ose jurisprudencë, si dhe kanë qenë profesionalisht të përfshirë (kanë punuar) për të paktën 3 (tre) vjet në një nga sektorët e mëposhtëm:

- i) sistemi bankar/financiar,
- ii) administrimi i rrezikut në tregjet financiare,
- iii) administrimi financiar,
- iv) auditimi,
- v) mbikëqyrja bankare/financiare,

vi) eksperiencia ligjore ose akademike e lidhur me tregjet financiare; ose
b) zotërojnë diplomë universitare në një fushë tjetër të ndryshme nga ajo e shkencave ekonomike ose të jurisprudencës, dhe kanë përvojë në sektorin bankar, të paktën 5 vjet.

4. Administratorët e propozuar për pozicionin e anëtarit të këshillit drejtues ose të drejtorisë, përveç kriterëve të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni, do të konsiderohet se zotërojnë përvojë

drejtimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në rastet kur plotësojnë edhe të paktën një nga kriteret e mëposhtme:

- a) kanë mbajtur një pozicion drejtues për të paktën 1 (një) vit në institucione financiare që veprojnë në tregun financiar të brendshëm ose të jashtëm;
- b) kanë mbajtur një pozicion drejtues për të paktën 1 (një) vit në një autoritet mbikëqyrës të tregut bankar/financiar në Shqipëri ose në një shtet tjetër;
- c) kanë mbajtur një pozicion drejtues për të paktën 2 (dy) vjet në persona juridikë të ndryshëm nga ata të përmendur në shkronjat “a” dhe “b” të këtij paragrafi.

Neni 14

Kërkesa në lidhje me dokumentacionin për miratimin e administratorëve

1. Subjekti paraqet një kërkesë me shkrim pranë Bankës së Shqipërisë për marrjen e miratimit paraprak për administratorin përkatës, të shoqëruar me dokumentacionin e përcaktuar në përputhje me pikën 2 ose 3 të këtij neni.

2. Dokumentet e mëposhtme, të shoqëruara me formularët e plotësuar sipas anekseve 1 dhe 2 të kësaj rregulloreje, i bashkëngjiten kërkesës:

- a) vendimi i organit kompetent me propozimin për emërimin e administratorit përkatës;
- b) dokumenti i identifikimit;
- c) diploma e arsimit të lartë;
- d) dokumentet, që vërtetojnë kualifikime të tjera të administratorit të propozuar;
- e) të dhëna të detajuara për veprimtarinë tregtare dhe për bizneset e tij për 5 (pesë) vitet e fundit, duke përfshirë dhe informacionin për pjesëmarrjet influencuese;
- f) të paktën një rekomandim lidhur me aftësinë profesionale, të lëshuar nga eprorë, punëdhënës të mëparshëm apo akademikë;

g) një përshkrim të detajuar të punës për pozicionin që do të mbajë administratori i propozuar;

h) deklaratë personale në lidhje me shlyerjen e të gjitha detyrimeve tatimore;

i) deklarata personale e administratorit të propozuar, se gjatë punësimit të mëparshëm nuk ka kryer veprimtari sipas përcaktimeve në nenin 41 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, e plotësuar sipas formularit të aneksit nr.2 të kësaj rregulloreje;

j) për administratorët e propozuar si anëtarë të këshillit drejtues, deklaratë personale për interesat privatë, sipas përcaktimeve të nenit 44 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”;

k) vërtetimet e mëposhtme të lëshuara nga organet kompetente, se:

i) personi nuk është në ndjekje penale,

ii) personi nuk është në gjykim për vepra penale,

iii) personi nuk është i dënuar penalisht (nga Ministria e Drejtësisë),

iv) personi nuk ka detyrime pasurore të pashlyera (nga Zyra e Përmbarrimit Gjyqësor).

v) Dokumentet e lartpërmendura duhet të jenë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së kërkesës.

3. Në rastin kur individ i propozuar për administrator është një shtetas i huaj, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 2 të këtij neni, subjekti paraqet në Bankën e Shqipërisë dhe lejen e tij të qëndrimit dhe të punës, në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”.

4. Për administratorin shtetas i huaj, vërtetimet e parashikuara në shkronjën “k” të pikës 2 të këtij neni do të paraqiten të lëshuara dhe nga organet kompetente të vendit të tij.

5. Dokumentacioni i përcaktuar sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni paraqitet në gjuhën shqipe, në origjinal ose në kopje të noteruar. Në rastin e dokumentacionit të lëshuar nga autoritetet zyrtare përkatëse të shteteve të huaja, ai legalizohet nga autoritetet përgjegjëse.

6. Dokumentacioni dorëzohet në Bankën e Shqipërisë me zarf të mbyllur ose dërgohet me postë të regjistruar.

Neni 15
Miratimi i administratorëve

1. Banka e Shqipërisë jep miratimin paraprak për emërimin e administratorit të propozuar pasi vlerëson reputacionin dhe kualifikimet mbi bazën e:

- a) dokumenteve të paraqitura në përputhje me pikën 2 të nenit 14, të kësaj rregulloreje;
- b) dokumenteve ose informacioneve të tjera që zotëron Banka e Shqipërisë;
- c) gjetjeve (konkluzioneve, përfundimeve) të vetë Bankës së Shqipërisë;
- d) kur çmohet e nevojshme, dhe mbi bazën e një interviste të zhvilluar nga Banka e Shqipërisë me administratorin e propozuar.

2. Procedura e shqyrtimit të dokumentacionit lidhur me dhënien e miratimit paraprak për emërimin e administratorit shtetas të huaj do të kryhet në dy faza, si më poshtë:

a) Në fazën e parë, Banka e Shqipërisë shpreh moskundërshtimin e saj për emërimin e administratorit shtetas të huaj kur, pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur në përputhje me kërkesat e pikës 2 të nenit 14 të kësaj rregulloreje, krijon bindjen se përmbushen kriteret e përcaktuara në nenin 13 të saj.

b) Në fazën e dytë, Banka e Shqipërisë jep miratimin paraprak për emërimin e administratorit shtetas të huaj, pas plotësimit të dokumentacionit në përputhje me pikën 3 të nenit 14, të kësaj rregulloreje.

3. Banka e Shqipërisë refuzon miratimin paraprak për emërimin e administratorit të propozuar, kur mbi bazën e vlerësimeve të saj rezulton se administratori i propozuar nuk plotëson kushtet dhe kriteret e vendosura në ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe në këtë rregullore.

4. Në rastin e refuzimit të kërkesës për miratimin paraprak për emërimin e administratorit të propozuar, Banka e Shqipërisë jep me shkrim arsyet e këtij refuzimi.

Neni 16
Miratimi në rast ndryshimi të pozicionit të administratorëve

1. Subjektet, për çdo riemërim të administratorëve në një pozicion të ndryshëm nga ai ekzistues, por që vazhdon të ruajë cilësinë e administratorit në kuptim të pikës 19 të nenit 4, të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, paraqesin në Bankën e Shqipërisë një kërkesë me shkrim për miratimin e këtij riemërimi. Kjo kërkesë shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) dokumentin e emërimit sipas shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 14 të kësaj rregulloreje;
- b) CV-në e plotësuar sipas aneksit nr. 1 bashkëlidhur kësaj rregulloreje;
- c) një përshkrim i detajuar i punës për pozicionin e ri që do të mbajë administratori i propozuar.

2. Banka e Shqipërisë mund të refuzojë dhënien e miratimit paraprak për riemërimin e administratorit sipas pikës 1 të këtij neni, kur mbi bazën e vlerësimeve të saj çmon se kualifikimet dhe përvoja e tij nuk janë të përshtatshme me pozicionin e ri si administrator.

Neni 17
Largimi i administratorëve

Subjektet njoftojnë Bankën e Shqipërisë brenda 30 (tridhjetë) ditëve për largimin e administratorëve të tyre, duke dhënë me shkrim arsyet përkatëse.

KREU IV
**MARRËVESHJET ME TË TRETËT PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE DHE
PËRGJEGJËSIVE PËR ADMINISTRIMIN DHE DREJTIMIN E BANKËS**

Neni 18
Kriteret në përfundimin e marrëveshjeve me të tretët

1. Banka, me miratimin paraprak të Bankës së Shqipërisë, mund të përfundojë me të tretët

marrëveshje për ushtrimin e funksioneve dhe përgjegjësi për administrimin dhe drejtimin e saj.

2. Banka, për ushtrimin e funksioneve dhe përgjegjësi nga të tretët:

a) harton dhe miraton një politikë për ushtrimin dhe kontrollin në mënyrë të përshtatshme të funksioneve dhe përgjegjësi nga të tretët;

b) siguron që vijimësia e veprimtarisë të saj, cilësia e shërbimeve dhe reputacioni i saj, nuk cënohen apo komprometohen nga transferimi i këtyre funksioneve dhe përgjegjësi;

c) siguron që ofruesi i shërbimit ka reputacionin dhe eksperiencën e duhur, si dhe një situatë financiare të qëndrueshme;

d) siguron që sistemi i kontrollit të brendshëm të përfshijë edhe funksionet dhe përgjegjësitë e deleguara të tretëve;

e) përcakton kriteret dhe harton metodat dhe procedurën për të ndjekur administrimin e rrezikut që rrjedh nga transferimi i funksioneve apo përgjegjësi;

f) sigurohet që ofruesi i shërbimit do të ruajë konfidencialitetin/sekretin e informacionit profesional të bankës dhe të klientëve, ndaj rrezikut të njohjes prej personave të paautorizuar;

g) sigurohet që marrëveshjet me të tretët nuk e zvogëlojnë aftësinë e saj për të përmbushur detyrimet ndaj klientëve ose të pengojnë mbikëqytjen efektive nga Banka e Shqipërisë.

3. Banka nuk mund të përfundojë me të tretët marrëveshje për të transferuar ushtrimin e funksionit të kontrollit të brendshëm dhe/ose për ushtrimin e veprimtarive bankare ose financiare të përcaktuara në nenin 54, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

4. Banka, pa miratimin e Bankës së Shqipërisë, mund të kontrakttojë dhe nënshkruajë marrëveshje me palë të treta për shërbimet e mëposhtme:

a) telefoni;

b) shërbime të informacionit të tregut si Bloomberg, Moody’s, Standard & Poors etj.;

c) rrjetet e infrastrukturës së përbashkët si VISA, Mastercard etj.;

d) funksione të cilat ajo nuk mund t’i kryejë vetë si: shërbime këshilluese, opinione juridike, vlerësime të pavarura etj.;

e) të tilla që përgjithësisht konsiderohen me rrezik të ulët si: shërbimi postar, shtypshkrimet, blerje mallrash e pajisjesh etj..

Neni 19

Kërkesa në lidhje me dokumentacionin për marrjen e miratimit paraprak, për përfundimin e marrëveshjeve me të tretët

1. Banka, me qëllim marrjen e miratimit paraprak të Bankës së Shqipërisë për marrëveshjet që do të përfundojë me të tretët për transferimin e funksioneve dhe përgjegjësi për drejtimin e saj, paraqet një kërkesë me shkrim pranë Bankës së Shqipërisë, të shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) projekt marrëveshjen e miratuar nga palët, e cila ndër të tjera përmban:

i. qëllimin e marrëveshjes,

ii. funksionet dhe përgjegjësitë që do të transferohen,

iii. marrëdhënien midis bankës dhe ofruesit të shërbimit (të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella të palëve),

iv. kushtet dhe/ose procedurat për zgjidhjen e marrëveshjes,

v. mënyrën dhe periodicitetin e raportimit nga ofruesi i shërbimit për bankën, lidhur me mbarëvajtjen e realizimit të shërbimit etj.;

b) një vlerësim për pritshmërinë e zbatimit të marrëveshjes lidhur me:

i. efektet e kësaj marrëveshjeje në qëndrueshmërinë financiare, reputacionin dhe veprimtarinë e bankës,

ii. performancën e pritshme të ofruesit të shërbimit,

iii. kostot dhe përfitimet që do të rrjedhin nga zbatimi i marrëveshjes;

c) aktet e brendshme lidhur me mënyrën dhe procedurat e zhvillimit të funksioneve dhe përgjegjësi të transferuara;

d) planin e vazhdimësisë (vijimësisë) së veprimtarisë/ve;

e) dokumentacionin me të dhënat identifikuese për ofruesin e shërbimeve, si më poshtë:

- i. statutin e shoqërisë,
 - ii. certifikatën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit si person juridik (për personat juridikë të huaj – aktet e barazvlefshme/ekuivalente juridikisht sipas legjislacionit/ juridiksionit të huaj),
 - iii. ekstraktin e Regjistrimit Tregtar të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, në të cilin të jetë përcaktuar dhe veprimtaria/të për të cilin/at është lidhur marrëveshja (për personat juridikë të huaj – aktet e barazvlefshme/ekuivalente juridikisht sipas legjislacionit/ juridiksionit të huaj),
 - iv. për administratorët e propozuar, dokumentacionin e parashikuar sipas kërkesave të pikës 2 të nenit 14, të kësaj rregulloreje;
 - f) vërtetimin nga autoritetet përkatëse për shlyerjen e detyrimeve fiskale të vitit të fundit financiar për ofruesin e shërbimit;
 - g) bilancin kontabël dhe pasqyrat financiare të ofruesit të shërbimit për vitin e fundit, të vërtetuara nga eksperti kontabël i autorizuar.
2. Dokumentacioni sipas pikës 1 të këtij neni paraqitet në gjuhën shqipe, në origjinal ose në kopje të notuar. Në rastin e dokumentacionit të lëshuar nga autoritetet zyrtare përkatëse të shteteve të huaja, ai legalizohet nga autoritetet përgjegjëse.
3. Dokumentacioni dorëzohet në Bankën e Shqipërisë me zarf të mbyllur ose dërgohet me postë të regjistruar.

KREU V DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 20 **Dispozitë kalimtare**

1. Administratorët e miratuar nga Banka e Shqipërisë përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, konsiderohen të miratuar sipas kërkesave të kësaj rregulloreje.
2. Për kërkesat për marrjen e miratimit paraprak për administratoret, të regjistruara në Bankën e Shqipërisë përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje dhe për të cilat është plotësuar i gjithë dokumentacioni i kërkuar nga rregullorja nr.120, datë 30.12.2003 “Për administratorët e bankave dhe të degëve të bankave të huaja”, e ndryshuar, do të zbatohen dispozitat e kësaj të fundit.

Neni 21 **Të fundit**

Aneksi 1 dhe aneksi 2 bashkëlidhur kësaj rregulloreje janë pjesë përbërëse e kësaj të fundit.

ZËVENDËSKRYETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Fatos Ibrahimi

Aneks 1

INFORMACION PËR KANDIDATIN PËR ADMINISTRATOR BANKE (Informacioni i dhënë konsiderohet sekret nga Banka e Shqipërisë)

1.	EMRI DHE SELIA E BANKËS	
2.	INFORMACION PERSONAL	
	Emri dhe Mbiemri	
	Adresa e banimit	
	Data dhe Vendi i Lindjes	
	Shtetësia	

Numri i telefonit të punës		
Numri i telefonit të shtëpisë		
Adresa E-mail		
3.	KUALIFIKIMI ARSIMOR (lutemi listoni në mënyrë kronologjike të gjitha institucionet arsimore që keni ndjekur, kohëzgjatjen e pjesëmarrjes, datën e diplomimit dhe titujt akademikë)	
4.	NIVELI I NJOHJES SË GJUHËVE TË HUAJA (lutemi listoni gjuhët dhe nivelin e njohjes së tyre)	
5.	TRAINIME TË AVANCUARA (lutem listoni në mënyrë kronologjike të gjitha kurset, periudhat, temat e kursit, organizatorët)	
6.	EKSPERIENCA NË PUNË (lutem listoni në mënyrë kronologjike të gjitha punësimet e mëparshme. Titullin e pozicionit dhe kohëzgjatjen e punësimit si dhe detyrat e kryera për secilën)	
	Periudha e punësimit (muaj/vit – muaj/vit)	
	Pozicioni (emërtimi i vendit tuaj të punës)	
	Përgjegjësitë (të detajuara)	
	Arsyet e largimit	Dorëheqje !__! Shkurtim i vendit të punës !__! Dalje në pension !__! Përfundimi i kontratës !__! Pushim nga puna !__! Të tjera !__! Specifiko
7.	EMRIN, POZICIONIN, ADRESËN E DY PERSONAVE NË SEKTORIN BANKAR APO FINANCIAR TË CILËT MUND TË SHPREHIN OPINIONET E TYRE NË KOMPETENCËN PROFESIONALE LIDHUR ME KOMPETENCËN PROFESIONALE DHE INTEGRITETIN E KANDIDATIT DHE INTEGRITETIN PERSONAL. (nëse këta persona nuk mbajnë më pozicionet e referuara në rregullore pohoni kur dhe ku ata i kanë patur këto pozicione)	1. 2.
8.	A keni ju ose persona të lidhur me ju përcaktuar sipas ligjit për bankat ndonjë marrëdhënie financiare me bankën (kredi, garanci etj.)? Nëse “po”, ju lutemi citojini ato.	

9.	A keni ju ose persona të lidhur me ju përcaktuar, sipas ligjit për bankat pjesëmarrje ose ndonjë interes tjetër financiar me bankën? Nëse “po”, ju lutemi citojini ato.	
10.	A keni ju ose persona të lidhur me ju të përcaktuar sipas ligjit për bankat, pjesëmarrje aksionere ose ndonjë interes tjetër financiar me ndonjë bankë tjetër ose kompani? Nëse “po”, ju lutemi citojini ato.	
11.	A jeni ju drejtues ose anëtar i bordit drejtues, ose një i prokuruar ose nëse merrni pjesë në ndonjë mënyrë tjetër në krijimin dhe implementimin e politikave të biznesit në ndonjë bankë tjetër, subjekt financiar jobankë apo shoqëri kursim-krediti ose në ndonjë institucion tjetër financiar apo kompani? Nëse “po”, ju lutemi citojini ato.	
12.	A ka raste në pjesëmarrjet tuaja si drejtues i një banke, kompanie apo institucioni financiar ku ju keni marrë pjesë në hartimin dhe implementimin e politikave të biznesit, të jeni ndeshur me vështirësi financiare që kanë rezultuar me fillimin e procedurave të riabilitimit apo falimentimit kundrejt këtyre kompanive apo institucioneve? Nëse “po”, lutemi listoni.	
13.	A keni qenë ndonjëherë i dënuar për kryerjen e një ose disa veprave kriminale referuar kërkesave të kësaj rregulloreje? Nëse jeni qytetar i huaj ose jetoni jashtë Republikës së Shqipërisë a jeni dënuar jashtë për akte kriminale? Nëse “po”, lutemi listojini.	
14.	A ka banka apo institucione financiare në të cilat ju keni patur pozicion drejtues dhe keni qenë të përfshirë në hartimin dhe implementimin e politikave të biznesit që të ketë qenë subjekt i masave ndreqëse (ndëshkuese) ose t'i jetë revokuar licenca për të vepruar nga institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen e bankave, kompanive të sigurimit dhe institucioneve të tjera financiare të	

	tregut? Nëse “po”, ju lutemi shpjegoni në mënyrë të plotë.	
15.	A ju është refuzuar apo revokuar ndonjëherë miratimi për mbajtjen e një pozicioni drejtues apo kryerjen e aktiviteteve në një fushë të caktuar operacionale? Nëse “po”, ju lutemi të shpjegoni në mënyrë të plotë.	
16.	A ka sipas opinionit tuaj ndonjë fakt tjetër apo rrethanë që mund (të gjykohet i arsyeshëm) të konsiderohet i rëndësishëm për vlerësimin e përshtatjes tuaj për pozicionin e administratorit të bankës (p.sh fakte dhe rrethana që lidhen me kualifikimet tuaja profesionale, vështirësi financiare ose konflikt interesi) ? Nëse “po”, ju lutemi listoni.	
17.	A keni ndonjë procedurë falimentimi të nisur ndonjëherë kundrejt pronës tuaj? Nëse “po”, shpjegoni në mënyrë të plotë.	

Unë deklaroj që të gjitha përgjigjet e mësipërme janë të vërteta dhe të plota dhe janë dhënë bazuar në dijeninë time, dhe nuk kam fshehur ndonjë informacion që mund të influencojë vendimin e Bankës së Shqipërisë.

Gjithashtu, unë do të informoj menjëherë Bankën e Shqipërisë për çdo ndryshim të mundshëm që mund të ketë efekt në dhënien e miratimit për emërimin tim si administrator.

Vendi dhe data:

Firma e Kandidatit

Aneksi 2

DEKLARATË

Në bazë dhe për zbatim të nenit 41 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” deklaroj me përgjegjësinë time të plotë si më poshtë vijon:

Deklarata personale

Po Jo

- është administrator i një shoqërie tjetër në Republikën e Shqipërisë, përveç rasteve kur kjo shoqëri është person i lidhur me të;
- është aksioner i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i më shumë se 5 për qind i aksioneve me të drejtë vote ose i aksioneve të një banke tjetër ose person i

- lidhur me të;
- c) shërben ose ka shërbyer në çdo kohë gjatë periudhës 5 vjeçare paraardhëse si administrator i një banke, e cila ka qenë subjekt i procedurave të likuidimit të detyruar sipas dispozitave të këtij ligji;
 - d) shërben ose kanë shërbyer në çdo kohë gjatë periudhës 12 mujore paraardhëse në Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë;
 - e) është punonjës i Bankës së Shqipërisë;
 - f) është në ndjekje penale ose është shpallur fajtor nga gjykata për një vepër penale për të cilin ligji parashikon dënimin me burgim;
 - g) ka qenë subjekt i procedurave të deklarimit të paaftësisë paguese të detyrimeve dhe nuk është çliruar ende nga pagesa e detyrimeve të shkuara;
 - h) është ndëshkuar nga Banka e Shqipërisë gjatë 5 vjetëve të fundit për shkelje të rëndë të këtij ligji ose për zhvillim të veprimtarisë pa licencën përkatëse të lëshuar nga Banka e Shqipërisë;
 - i) është punonjës ose ortak i një shoqërie që është ekspert kontabël ose konsulent financiar i një banke ose i një dege të bankës së huaj që vepron në territorin e Republikës së Shqipërisë;
 - j) detyrimet e tij tejkalojnë pretendimet dhe investimet e tij në bankë ose kur është i lidhur me persona juridikë, detyrimet e të cilëve ndaj bankës tejkalojnë pretendimet dhe investimet e tyre në bankë;
 - k) është kreditor dhe njëkohësisht vlera e përgjithshme e kredive të tij ndaj bankës tejkalon një të katërtën e aktiveve të saj.

Vendi dhe data:

Firma e Kandidatit

VENDIM
Nr.41, datë 25.5.2009

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE STANDARDE TË
TENDERIMIT PËR KUSHTET E FINANCIMIT TË OSSH SHA**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, ligjit nr.10116, datë 23.4.2009 “Për miratimin e kontratës së shitjes së 76% të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë dhe CEZ a.s-së”, (aneksi 11), ligjit nr.10126, datë 11.5.2009 “Për miratimin e marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për garantimin e projektit të privatizimit të OSSH sh.a.”, Bordi i Komisionerëve në mbledhjen e tij të datës 25.5.2009, duke konstatuar se procedurat standarde të tenderimit për kushtet e financimit të OSSH sh.a. janë pjesë përbërëse e ligjit nr.10126, datë 11.5.2009,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave dhe procedurave standarde të tenderimit për kushtet e financimit të OSSH sh.a., sipas procedurave që përmban aneksi 3 i marrëveshjes për mbështetjen qeveritare, që është pjesë e aneksit 1 të Marrëveshjes së Garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për garantimin e projektit të privatizimit të OSSH sh.a., miratuar me ligjin nr.10126, datë 11.5.2009.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.42, datë 25.5.2009

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE STANDARDE TË
PROKURIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA OSSH SHA**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, ligjit nr.10116, datë 23.4.2009 “Për miratimin e kontratës së shitjes së 76% të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë dhe CEZ a.s-së”, (aneksi 11), ligjit nr.10126, datë 11.5.2009 “Për miratimin e marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për garantimin e projektit të privatizimit të OSSH sh.a.”, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 25.5.2009, duke konstatuar se procedurat standarde të prokurimit të energjisë elektrike nga OSSH sh.a. janë pjesë përbërëse e ligjit nr.10126, datë 11.5.2009,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave dhe procedurave standarde të prokurimit të energjisë elektrike nga OSSH sh.a., sipas procedurave që përmban aneksi 3 i marrëveshjes për mbështetjen qeveritare, që është pjesë e aneksit 1 të Marrëveshjes së Garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për garantimin e projektit të privatizimit të OSSH sh.a., miratuar me ligjin nr.10126, datë 11.5.2009.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.43, datë 28.5.2009

**PËR MIRATIMIN E TRANSFERIMIT TË ASETVE NGA SHOQËRIA KORPORATA
ENERGJETIKE SHQIPTARE SHA TEK SHOQËRIA OPERATORI I SISTEMIT TË
SHPËRNDARJES SHA**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 20 pika “1” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, duke qenë se “Rregullorja për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, nuk zbatohet në këtë rast (sipas nenit 4 pika 3), Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.5.2009, mbasi shqyrtoi kërkesën për miratimin e transferimit të aseteve nga shoqëria Korporata Energjetike Shqiptare sh.a. te shoqëria Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a., të miratuara me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.969, datë 2.7.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në administrim të OSSH sh.a.”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1108, datë 30.7.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në administrim të OSSH sh.a.”, dhe ligjit nr.10116, datë 23.4.2009 “Për miratimin e kontratës së shitjes së 76% të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë dhe CEZ a.s-së”, si dhe çdo transferim tjetër të

kryer nga Korporata Energjetike Shqiptare sh.a. te shoqëria Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a.,

VENDOSI:

1. Të miratojë transferimin e aseteve nga shoqëria Korporata Energjetike Shqiptare sh.a. tek Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a., miratimi i të cilave është bërë me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.969, datë 2.7.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në administrim të OSSH sh.a.”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1108, datë 30.7.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në administrim të OSSH sh.a.” dhe ligjit nr.10116, datë 23.4.2009 “Për miratimin e kontratës së shitjes së 76% të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë dhe CEZ a.s-së”, si dhe çdo transferim tjetër të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme nga shoqëria Korporata Energjetike Shqiptare sh.a. te shoqëria Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a., nga momenti i kryerjes së çdo transferimi.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.44, datë 28.5.2009

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË PRONËSISË SË AKSIONEVE TË OPERATORIT
TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SHA (OSSH)

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, ligjit nr.10116, datë 23.4.2009 “Për miratimin e kontratës së shitjes së 76% të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë dhe CEZ a.s-së”, paragrafit 5.2 të “Licencës së aktivitetit të furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr.71, datë 24.6.2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, dhe vendimit nr.69, datë 24.6.2008 “Për miratimin e licencës së aktivitetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.5.2009, mbasi shqyrtoi kërkesën e OSSH sh.a. për miratimin e transferimit të pronësisë së aksioneve që përfaqësojnë 76% të kapitalit aksionar të shoqërisë OSSH sh.a., nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (që vepron në cilësinë e përfaqësuesit të Republikës së Shqipërisë), te shoqëria CEZ a.s,

VENDOSI:

1. Të miratojë transferimin e pronësisë së aksioneve që përfaqësojnë 76% të kapitalit aksionar të shoqërisë OSSH sh.a., nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (që vepron në cilësinë e përfaqësuesit të Republikës së Shqipërisë), te shoqëria CEZ a.s, nga momenti i kryerjes së çdo transferimi.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.45, datë 28.5.2009

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË “FAVINA 1” SHPK ME SERI PV05V, NR.29,
LËSHUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR.85, DATË
27.12.2005**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 10, pika “3” dhe nenit 15 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, dhe nenit 18 pika 1, germa “a”, të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin nr.21, datë 18.3.2009 të Bordit të Komisionerëve, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.5.2009, mbasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “Favina 1” sh.p.k., për ndryshimin e licencës nr.29, seria PV05P, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.85, datë 27.12.2005 dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, dhe konstatoi paraqitjen e plotë të dokumentacionit siç kërkohet nga “Rregullorja për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për ndryshimin e licencës nr.29, seria PV05P, të shoqërisë “Favina 1” sh.p.k., për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.85, datë 27.12.2005.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.46, datë 28.5.2009

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR.63,
DATË 13.6.2008 “PËR DHËNIEN E LICENCËS NË AKTIVITETIN E NDËRTIMIT,
INSTALIMIT DHE SHFRYTËZIMIT TË CENTRALEVE ELEKTRIKE ME ERË DHE
PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE”
(PARKU EOLIK KAVAJË)**

Në mbështetje të neneve 9, 13 pika 1, germa a, dhe 15 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe neneve 121 dhe 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.2008 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.5.2009, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “ERS-08” sh.p.k. për shtyrjen e afateve të përcaktuara në vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.63, datë 13.6.2008 “Për dhënie e licencës në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë dhe prodhimin e energjisë elektrike” (Parku eolik Kavajë), dhe e konsideroi të drejtë atë,

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.63, datë 13.6.2008 për dhënien e licencës “Në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë dhe prodhimin e energjisë elektrike nga “Parku eolik Kavajë” të bëhet ky ndryshim:

- në pikën 1, germa “a”, afati prej 12 muajsh të ndryshohet dhe të bëhet 18 muaj.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data e hyrjes në fuqi të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.63, datë 13.6.2008.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.47, datë 4.6.2009

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR PJESËMARRJE NË TREG

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 25 të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr.21, datë 18.3.2009 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.68, datë 23.6.2008 “Rregullat e tregut shqiptar të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë Elektrike”, në mbledhjen e tij të datës 4.6.2009, pasi shqyrtoi dhe analizoi kërkesën e OST sh.a. për miratimin e marrëveshjes për pjesëmarrjen në treg,

VENDOSI:

1. Miratimin e “Marrëveshjes për pjesëmarrje në treg”.
 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për zbatimin e këtij vendimi.
 3. Bashkëlidhur me këtë vendim marrëveshja për pjesëmarrje në treg.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
- Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë

Hyri në shtyp më 25.6.2009
Doli nga shtypi më 25.6.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 24 lekë